

Trajneri dhe futbollistët e Besës së Pejës, kishin planifikuar që të premtën (dje) të mbanin stërvitje në ora 13:00. Një gjë e tillë nuk ndodhi për një arsye siç thonë lojtarët, shumë të fortë. “Për shkak se xhumaja falet në ora 12:00, jemi marrë vesh së bashku me trajnerin që stërvitjet t’i mbajmë nga ora 14:00”, thonë disa nga futbollistët pejan për t’u ndalur më shumë në këtë çështje, portieri Flamur Neziri.

“Zakonisht stërvitjet i mbajnë 24-orë para ndeshjeve, për t’iu përshtatur orarit të ndeshjes. Tanimë e kemi ndërruar orarin për faktin se të gjithë lojtarët e falim namazin e xhumasë. Është gjë shumë e mirë nga ana e trajnerit Arbnor Morina, i cili i ka mirëkuptuar lojtarët dhe për këtë fakt, duam që ta falënderojmë. Edhe ai e fal xhumanë”, ka thënë ‘gardiani’ Flamur Neziri për Arenën.

Edhe klubi më i madh kosovar, Prishtina e ndërron orarin e stërvitjeve për shkak të xhumasë. “Një ditë para ditës së xhumasë, bisedojmë për orarin e stërvitjeve, gjithmonë e lëmë në kohën që na konvenon për ta arritur xhumanë. Namazi është obligim i çdo myslimani, kështu që bisedojmë me shtabin teknik për çështjen e orarit. Në ekipin tonë thuajse 75 për qind e lojtarëve e falin namazin e xhumasë”, njofton për gazetën kapiteni i Prishtinës, Driton Krasniqi./Arena/